

THE TOPIC OF MARRIAGE IN A. Z. ÇAJUPI'S COMEDY "14 VJEÇ DHËNDËRR" (A FOURTEEN-YEAR-OLD GROOM) AND MOLIERE'S "L'ÉCOLE DES FEMMES" (THE SCHOOL OF WOMEN)

TEMA E MARTESËS NË KOMEDINË "14 VJEÇ DHËNDËRR" TË A. Z. ÇAJUPIT DHE "L'ÉCOLE DES FEMMES" ("SHKOLLA E GRAVE") TË MOLIERIT

VALBONA GASHI-BERISHA
Universiteti i Ptitstines, Prishtinë, KOSOVA
valbonagb@hotmail.com

AKTET V, 4: 742 - 746, 2012

PERMBLEDHJE

Pothuajse secila komedi e Molierit prek temën e martesës e cila gjen rëndësi të veçantë edhe në komedin 14 vjeç dhëndërr e Çajupit. Kjo temë është çështje konflikti në mes gjeneratave, në mes gjinisë po edhe në mes klasave shoqërore. Fuqia prindërore manifestohet me rastin e martesës. Babai vendos për martesën e femijëve sipas dëshirës së tij dhe interesit personal. Nënshtrimi i gruas në kohën e Molierit sikurse në kohën e Çajupit ishte permanent nga autoriteti i babait në ate të burrit. Kontrata e martesës i jep tërë autoritetin burrit sikur në planin ekonomik poashtu edhe në planin moral. Mirëpo përkundër kësaj, në këto dy komedi gjejmë revoltën e gruas kundër këtyre traditave. Gruaja përdor dinakërin dhe gënjeshtren për të luftuar kundër këtij rregulli të shoqërisë patriarkale.

Fjalët kyçe: Martesë, interes, prind, fëmijë, grua, burrë.

SUMMARY

Almost every Moliere's comedy tackles the topic of marriage, which finds particular importance in Çajupi's comedy "14 vjeç dhëndërr" as well. This topic is a conflict issue between generations, sexes, and social classes as well. The parental power is manifested on marriage. The father decides about the marriage of his children according to his will and personal interest. Woman's submission in Moliere's time, as in Çajupi's time, was permanent, from father's to husband's authority. The marriage contract gives full authority to the husband, be it in economic or moral aspect. However, despite all that, in these two comedies, we find woman's revolt against these traditions. She uses cunning and deception to fight this rule of patriarchal society.

Key words: Marriage, interest, parent, children, woman, husband

1. Hyrje

"*Shkolla e grave*" është një ndër komeditë më të njohura të Molierit e shkruar në vitin 1662 dhe e prezantuar për herë të parë një vit më pas. Komedia e Çajupit "*14 vjeç dhëndërr*" është shkruar në vitin 1902 në përmbledhjen poetike "Baba Tomori" në librin e tretë. Molieri dhe Çajupi kanë shkruar për tema që edhe sot janë ende aktuale: martesë, mardhëniet martesore, roli i femrës në shoqëri dhe shumë tema të tjera të cilat janë të lidhura ngushtë njëra me tjetrën.

Komeditë më të njohura të Molierit trajtojnë temën e martesave për interes madje lidhja e tij me komedinë "*Shkolla e grave*" është mjaft komplekse: e shkruan këtë komedi në vitin e martesës së tij me Armande Bejart, njëzet vjet më e re dhe sidomos është vajza e Madeleine, dashnores së vet. Në këtë aspekt, Molieri vë në lojë biografin e tij që kritikohet dhe konsiderohet si incest. Kjo temë ka qenë, dhe është ende, frymëzim në letërsi, muzikë, art dhe në fusha

tjera dhe është temë studimi në domene të shumta si në drejtësi, sociologji, etnologji etj.

Martesa, qysh në Mesjetë, rregullohej në atë mënyrë, për të parandaluar lidhjet e padëshiruara, siç është fjala për dashurinë kurtuazive, dashuri jashtë martesore e cila konsiderohej si shkelje kurore. Në shekullin e XVII, dashuria i është nënshtruar autoritetit të prindit, temë kjo e cila gjen vend të rëndësishëm në komeditë e Molierit e gjithashtu edhe në komedinë e Çajupit. Gjithashtu, gjatë gjithë shekullit të XVIII dhe XIX paraprin martesa për interes. Mund të themi se vetëm në shekullin e XX triumfon martesa me dashuri.

Në këtë punim ne do të fokusohemi vetëm në martesën për interes, temë kjo që gjen ngjashmëri te Molieri dhe Çajupi, dhe e paraqitur mjaftë mirë në formë komike. Kështu pra, tema e martesës në këto dy komedi, edhe pse shumë e ndryshme njëra nga tjetra, ka si element të përbashkët interesin. Për të shprehur më mirë çështjen e martesës në këto dy komedi, është e domosdoshme një paraqitje sado e vogël e situatës së femrës në atë kohë.

2. Nënshtrimi dhe emancipimi i femrës

Femra në këtë kohë ka qenë e nënshtruar në mënyrë permanente nga burri. Sipas rrethanave shoqërore, ajo kalon nga autoriteti i babait në atë të burrit. Femra ka pozitë inferiore ndaj burrit. Inferioriteti i gruas shihet qartë në Kontratën e martesës e cila i jep të gjitha të drejtat burrit sikur në shoqërinë juridike në kohën e Molierit po ashtu edhe në shoqërinë kanonike të Çajupit. Detyrimet më të rëndësishmet në lidhjen martesore ceken në *Kanunin e Lekë Dukagjinit* (Nyje I trembëdhjetë, § .32 dhe 33.

Shpesh herë, femra, në kohën e Molierit, vendosej nga prindi në manastir deri në martesë (fenomen që ishte në modë).

Në fëmijëri, Agnesa është mbyllur në një manastir, pastaj në shtëpinë e Arnolfit është ruajtur nga shërbëtorët. Fati i femrës së nënshtruar në komedinë “14 vjeç dhëndërr” paraqitet me Tanën e cila qysh në fillim e tregon gjendjen e saj të rëndë duke thënë se : “ tërë ditën ngas qetë/ dhe drekë e darkë bëj

vetë ”⁵. Burri i saj Vangjeli, edhe pse indiferent ndaj disa gjërave, ai nuk ngurron t'i kundërpërgjigjet : “Gratë për punë po janë”. (Akti i I)

Në komedinë “*Shkolla e grave*”, Arnolfi, dëshiron të martohet, mirëpo ka shumë frikë se do ta tradhtojë gruaja. Në një takim që ka me shokun e vet Krizaldin, Arnolfi përshkruan gjithë fatkeqësinë që e kaplon burrin sapo të martohet. Për të realizuar martesë ideale, ai ia ka arritur qëllimit duke e rritur Agnesën (vajzën e shokut të vet) në inorancën e jetës dhe duke e vendosur në manastir për ta larguar nga realiteti. Horaci, djali i Orontos (shok tjetër i Arnolfit), në shikim të parë ka rënë në dashuri me Agnesën ; për këtë i tregon Arnolfit, duke mos ditur rolin e tij si tutor dhe duke e përqeshur personazhin e M de la Souche.

Është e vërtetë se, me gjithë rolin e rëndësishëm që ka pasur gruaja gjatë shekujve, influenca e saj në zhvillimin e zakoneve dhe jetës në përgjithësi nuk ishte aspak e favorshme. Roli i saj në shoqëri ishte madje i nënçmuar, siç e shohim edhe në këto dy komedi. Jeta e saj është e udhëhequr nga burri, djali apo vëllau. Ajo që kishte rëndësi te një grua ishte bukuria e jashtme dhe aftësia për të lindur fëmijë, sidomos djem.

Mund të themi se shekulli i XVII shënon fillimin e emancipimit të femrës në rrethet aristokratike dhe intelektuale. Në sallonet e shumta parisienne të asaj kohe, femrat intelektuale i përcaktojnë raportet shoqërore në mes burrit dhe gruas. Këto femra nuk kanë pushtet politik, mirëpo e dënojnë ashpër brutalitetin e burrave e sidomos tiranin e martesës. Burrat kanë frikë nga këto femra të emancipuara, për këtë arsye Arnolfi dëshiron të martohet me një grua që nuk din të lexoj, nuk din të shkruaj. A. Adam në *Histoire de la literature francaise* e paraqitet Arnolfin si personazh me kundër argumente: “Ky i ashtuquajtur i mençur nuk ju mëson burrave, aspak mençurinë, por kënaqësinë qesharake...”. Arnolfi është qesharak, gjeloz, naiv. Naiviteti i Arnolfit shihet qartë kur shprehet se burrat rrezikojnë të tradhtohen nga gruaja e cila është e edukuar kështu që është më mirë të martohen me budallaqe: “ Të martohesh

me një të marrë është të mos bëhesh vet aspak i marr”.

Agnesa, e rritur në injorancën e plotë, është një vajzë e pafajshme dhe injorante në fillim të komedisë, mirëpo, më vonë ajo dashurohet dhe është e gatshme të bëjë çmos për të dashurin e saj. Në aktin e II, Arnolfi qorton ashpër shërbëtorët e tij, Alanin dhe Zhorzhetën, pasi që këta të fundit i kishin lejuar një të riu ta takojë Agnesën. Për të ditur se çfarë ka ndodh në mes dy të rinjve, Arnolfi e pyet Agnesën hollësisht sa i përket këtij takimi. Edhe pse sigurohet se s’ka ndodh asgjë, Arnolfi vendos të përshpejtoj martesën. Agnesa i shpreh falënderimet e saj Arnolfit, pasi që e konsideron si baba duke menduar se bëhet fjalë për martesën e saj me Horacin.

Arsimimi i femrës është mjaft mospërfillës në kohën e Molierit dhe i parëndësishëm në kohën e Çajupit. Sipas Arnolfit, duhet pasur kujdes për kuriozitetin e gruas dhe dëshirën për dituri. Ai ka frikë se gruaja që do të martohet me të, do të bëhet inteligjente dhe e ditur. Dëshira e tij është që femra me të cilën do të martohet, të mbetet injorante.

Personazhi tipik i femrës fshatare në Shqipërinë e asaj kohe, Tana, nuk ka madje as kohë të mendojë dhe të dijë për emancipimin e femrës. Preokupimet e saj janë të merret me të gjitha punët që familja ka nevojë, ndërsa burri i saj plot krenari shprehet:

“Jam Shqiptar i vërtetë,
Do të bëj si dua vetë!” (Akti i I)

3. Martesa komike

Për të kuptuar më mirë këto dy komedi, është e domosdoshme të shohim më për së afërmi kontekstin shoqëror dhe kulturor të kohës së Molierit dhe të Çajupit. Franca e kohës së Molierit udhëhiqej nga mbreti Luigji i XIV. Jeta në oborin mbretëror padyshim se ishte më e mirë dhe shumë borgjez dhe të pasur dëshironin të kishin statutin e fisnikut. Kështu që, ky fenomen ka gjet vend edhe në komedin “*Shkolla e grave*”.

Jeta shoqërore dhe politike e kohës shprehen dukshëm edhe në komedinë “*14 vjeç dhëndërr*” ku skena plot humor paraqesin realitetin e fshatit

malor të Shqipërisë së Jugut. E veçanta e kësaj komedie është se humori është në harmoni me jetën e përditshme të personazheve popullore që godasin zakonin e martesave të parakohshme. Jeta e vështirë, sidomos në fshatrat malore, bëri që për shkak të kushteve të rënda ekonomike të mos mirren parasysh ndjenjat dhe dëshirat e të rinjve për martesë.

Akti i parë në të dy komeditë e prezanton Agnesën dhe Marigonën pa qenë prezente në skenë. Prezantimi i Agnesës fillon prej aktit të dytë, skena e 5 gjatë një bisede të shkurtër kur pohon, në mënyrë naive, se është takuar me Horacin. Në komedinë “*14 vjeç dhëndërr*”, Marigona prezantohet nga Tana, grua e cila insiston pranë burrit të vet ta martojnë djalin e vetëm Gjinon. Edhe pse Marigona më e madhe në moshë sesa Gjino që është vetëm 14 vjeç, Tana shprehet qartë se: “nuk do nuse për sisë, po për punët e shtëpisë” (akti i I). Interesi i Tanës shprehet qartë se nusja e të birit “punon vetëm sa dhjetë!” (Akti I,) dhe nuk mendon fare se një martesë e tillë nuk i sjell lumturi as Gjinos dhe as Marigonës. Martesat e rregulluara për interesa, të natyrave të ndryshme, ishin një fenomen që ndodhnin në Shqipëri e po ashtu edhe në Kosovë e Maqedoni, për arsye të mërgimit familjet mbeteshin pa burra kështu që gratë duhej të siguronin ekzistencën për jetë.

Hera e parë që duket Agnesa para syve të Arnolfit, ka katër vjet. Ajo bëhet objekt i ëndrrave të Arnolfit i cili vendos ta rris dhe edukoj sipas dëshirës së vet. Ai dëshiron të bëjë një ikonë të femrës së nënshtruar, për çka ai mendon se do të ketë sukses në shoqëri dhe do të ishte krenar të tregonte shembullin e përkryer në relacionin martesor.

Molieri e ka paraqitur Agnesën me një çiltërsi dhe një freski që e zgjojnë shpirtin e saj për dashuri dhe për jetë. Edhe kur i shkruan letrën Horacit, ajo shprehet me thjeshtësi dhe sinqeritet që tregon emocionet e një dashurie të çiltër. Ndërsa, Arnolfi është personazh që përfaqëson borgjezinë sipas Molierit, është i paafët të flas për dashuri me fjalë sentimentale. Ai na ofron çaste nga më komiket kur dëshiron të shprehet me fjalë të ëmbla (shih aktin V). Ai nuk gjen fjalë dashurie, i

mungojnë ato para Agnesës dhe shprehet në mënyrë vulgare: “Dëshiron të më shohësh duke qarë? Dëshiron që të rrah vetveten? Dëshiron që të shkul flokët e mija?”

Pafajësia dhe injoranca e Agnesës janë të paraqitura qysh në fillim dhe se Arnolfi përfiton nga kjo gjendje e saj duke thënë: “ta bëjmë idiote aq sa të mundemi”. Megjithatë, fundi i skenës tregon tashmë një ndjenjë dashurie, që ajo nuk dinë t’a përcaktoj: “ [...]diçka brenda turbullon/Sigurisht se nuk e di dhe se jam e mallëngjyer.” (v. 563-564). Pak nga pak, përball thashethemeve të Arnolfit, ajo vetëdijësohet. Në fillim ajo merr guximin ta kundërshtoj: “Oh! aspak. Më ka thënë më shumë se njëzetë herë” (v. 593).

Te komedia “14 vjeç dhëndërr”, imagjinata e fëmijës, siç është rasti i Gjinios, nuk përputhet me imagjinatën e Marigonës, të cilës i imponohet një jetë që nuk e ëndërron. Mund të themi se imagjinata e Gjinios dhe Agnesës është e padjallëzuar dhe e pastër, ata obligohen për martesë pa u pyetur fare. Kur është rasti për martesë, nuk bëhet asnjë kërkesë nga ana e Arnolfit: ai e obligon Agnesën të martohet me te. Sipas zakoneve të shekullit të XVII, Arnolfi 42 vjeçar kishte moshën për martesë edhe pse në ditët e sotme konsiderohet më i vjetër: dëshira e tij për tu martuar me Agnesën nuk është aspak skandaloze; martesë të tilla ishin të zakonshme për atë kohë. Edhe Gjinon nuk e pyet askush për martesë, vendimin e merr prindi, kështu që nuk bëhet fjalë asnjëherë për dashuri dhe as për ndjenjat e tij.

4. Revoltimi i Agnesës dhe Marigonës

Molieri dhe Çajupi janë të vetëdijshëm për padrejtësitë që ju bëhen femrave. Personazhet e tyre Agnesa dhe Marigona, të shtypura padrejtësisht revoltohen së pari kundër traditës që ka femra në rrethin ku jeton pastaj edhe kundër personave që sillen në mënyrë tiranike. Ato bëhen avokate të të drejtave të femrës sidomos sa i përket martesës. Ato përdorin mënyra të ndryshme të dinakërisë dhe gënjeshtërisë për të luftuar gjendjen patriarkale të

shoqërisë ku ato jetojnë. Nuk kanë shumë zgjidhje në një shoqëri tiranike dhe të mbyllur.

Evoluimin e Agnesës e mësojmë nga Horaci. Ajo i shkruan një letër dashurie Horacit ku shprehet mjaft mirë fuqia e dashurisë së saj me disa fjalë që tregojnë më së miri guximin e saj (Akti III, skena 4). Vendimin që ndërmer, për të pritur Horacin në dhomën e vet dhe për ta fshehur kur vjen Arnolfi (Akti IV, skena 6), tregon faktin se tani është e gatshme të luftojë për dashurinë e saj: tani ajo ka moshën madhore. Mirëpo, tani në këtë moshë, ajo ka humbur «pafajësinë», në kuptimin etimologjik të fjalës, d.m.th. se ajo mund të bëjë të vuaj një mashkull. Këtë lloj evolucioni të Agnesës e cek mjaft mirë Arnolfi në skenën e 4 të aktit të V: “Edhe dini të leni takime natën/ Dhe të shkoni mbrapa dashnorit pa bërë asnjë zhurmë”.

Sa i përket revoltës së Marigonës ajo shprehet mjaftë qartë qysh në momentin e parë kur mbetet vetëm në dhomë me burrin e saj 14 vjeçar. Mirëpo, pafajësia e dhëndrit krijon një situatë të rëndë për qiftin e posa martuar kur thotë:

“Lozëm no një lodër?
Të dua si motër...”

Ndërsa dëshpërimi i nuses, Marigonës shprehet me ironi:

“Ç’motër më ke mua,
O lum’ e përrua?
Ti më more grua” (Akti IV, skena 5)

5. Konkluzion

Dashuria e Agnesës dhe e Marigonës është dashuri e ndjenjave dhe jo e interesave. Pavarësisht prej asaj se martesë është e shenjtë dhe ju sjell njerëzve lumturi, për personazhet e këtyre komedive, martesë e rregulluar ishte në shënjestër për përfitime personale. Me anën e satirës, Molieri dhe Çajupi kritikojnë këto martesë që nuk kishin aspak vëmendje për dashurinë dhe ndjenjat e të rinjve. Për këtë arsye bëheshin edhe kontratat e martesës, kontrata që duhej, sipas zakonit të asaj kohe, të respektoheshin nga qifti bashkëshortor. Megjithatë, shumë pak njerëz i respektonin këto rregulla morale. Humori i përzgjedhur i Molierit dhe Çajupit tregon anën

naive dhe nënshtrimin e femrës, jo për ta nënçmuar por përkundrazi për t'i përshkuar zakonet dhe sistemin e shoqërisë që i jepte të gjitha të drejtat burrit. Në komeditë e tyre shohim femrën që gjykon, që rregullon jetën në shtëpi, që është dinamike pa marrë parasysh se në çfarë shtrese bënë pjesë. Ata përshkruajnë pabarazinë që mbretëron në mes burrit dhe gruas dhe me personazhe nga më të thjeshtit paraqesin portretin e tërë një shoqërie. Molieri dhe Çajupi kanë vendosur ballë për ballë martesën dhe dashurinë që sipas traditës parashikohet vetëm e para, mirëpo është e dyta e cila triumfon.

Bibliografia

ADAM, Antoine (1997), *Histoire de la littérature française au XVIIe siècle*, collection «

Bibliothèque de l'Évolution de l'Humanité », Éditions Albin Michel, 3 vol.

ADAM, Antoine (1997), *Histoire de la littérature française*, Ed. Albin Michel, Paris, II.

COUTY Daniel (2004), *Histoire de la littérature française*, Editions Bordas, Paris.

ÇAJUPI, Anton Zako (1983), *14 vjeç dhëndërr*, Shtëpia botuese "Naim Frashëri" Tiranë.

GJEÇOV, Shtjefën (1995), *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Prishtinë.

MOLIÈRE (1985), *L'école des femmes*, Éditions Gallimard, Paris.

MOLIÈRE (2010), *L'école des femmes*, Éditions Pocket, Paris.

SHUTERIQI, Dhimitër S. (1971), *Historia e letërsisë shqipe*, vëllimi 1 dhe 2, Prishtinë.